



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

**K.Dh.Shk II.nr.193/24**

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**, Dhoma e shkallës së dytë, me gjyqtarin Faton Bajrami në çështjen përmbarimore të kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" sha, me seli ne Prishtine, kundër debitorit Matrix Internet-Cafe, me adrese ne rr. "Dardania" ne Prishtine duke vendosur lidhur me ankesat e kreditorit të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.388/22 të datës 23.10.2023, me datë **05.06.2024**, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

**REFUZOHET** si e pabazuara ankesa e kreditorit Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Prishtina" sha, me seli ne Prishtine, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike KPPP.nr.388/22 të datës 23.10.2023, **VËRTETOHET**.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.388/22 të datës 23.10.2023, ka vendosur si ne vijim:

I. Pranohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Matrix Internet-Cafe ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbarimor P.nr. 94/2020 i datës 09.03.2020, i lejuar nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, per pjesën e detyrimit ne vlere prej 2,269.94 EUR dhe procedura ne këtë pjese te përmbarimit **PERFUNDOHET**.

II. Refuzohet pjesërisht prapësimi i debitorit Matrix Internet-Cafe ashtu qe mbetet ne fuqi Urdhri Përmbarimor P.nr.94/2020 i lejuar me date 09.03.2020, nga Përmbaruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi për pjesën e detyrimit ne vlere prej 91.80 EUR.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka paraqitur ankesë, pala kreditore (*me pretendime sikur në ankesë*), me propozimin qe gjykata e shkallë se dytë ta rishikoj aktvendimin e shkalles e parë, duke e aprovuar ankesën si et bazuar dhe te anuloj aktvendimin e Gjykatës Komerciale - Dhomat e Shkallës së parë, KPPP.nr.388/22 të datës 23.10.2023.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

- **Ankesa është e pathemeltë.**

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Kompania Rajonale Ujësjetllësi "Prishtina" sha, me seli ne Prishtine, ka paraqitur propozim për përmbarrim mbi bazën e dokumentit të besueshme – Ekstraktit nga librat e kontabilitetit me shifër 94959, ka lejuar Urdhrin Përmbarrimor P.nr.94/20 të datës 09.03.2020, duke urdhëruar që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri t'i paguaj kreditorit shumën e mbetur prej 2,269.94 €, si dhe shpenzimet procedurale, me regjistrimin.

Përmbarruesi Emine Sherifi – Lubeniqi, me seli në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbarrim të kreditorit me urdhrin përmbarrimor P.nr.94/20 të datës 09.03.2020, e ka lejuar përmbarrimin e propozuar nga kreditori, ndërsa debitori ka ushtruar prapësim duke kundërshtuar Urdhrin për lejimin e përmbarrimit, me arsytim se dokumenti ne baze te cilit ishte marre urdhri përmbarrimor nuk i ka tiparet e përmbarrueshmerise e qe është ne kundërshtim me nenin 27 par.1 lidhur me nenin 71 par 1 pika 1.1 dhe 1.4 e LPP-se. Tutje ka shtuar se ne kartelën financiare te konsumatorit ashtuquajtur dokument autentik nuk kanë te evidentuare te dhëna baze te debitorit (adresa e sakte e shfrytëzuesit te shërbimit-furnizim me ujë, emri i pronarit, numri i regjistrimit te biznesit, adresa e sakte e biznesit) por vetëm emri "Matrix Internet Caffe" i cili është kopjuar reklama e vendosur para lokalit, andaj debitori nuk është pronar i lokalit por vetëm shfrytëzues dhe asnjëherë nuk ka pasur kontrate apo shërbim - furnizim me ujë me kreditorin. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar qe ta aprovoj si te bazuar prapësimin e debitorit, urdhri përmbarrimor te anulohet, ndërsa te detyrohet kreditorit qe ti paguaj te gjitha shpenzimet e procedurës përmbarrimore.

Kreditori, ka ushtruar përgjigje ne prapësim duke kundërshtuar pretendimet e debitorit me arsytimin se ne rastin konkret nuk kemi te bëjmë me afatin e përgjithshëm te parashkrimit pasi qe parashkrimi ndërpritet kur debitori e pranon borxhin sipas nenit 368 par 2 te LMD-se. Po ashtu, nuk qëndrojnë pretendimet e debitorit sa i përket shërbimeve te ujësjetllësit për faktin se debitori ka pranuar shërbimet e ujësjetllësit për do muaj nëpërmjet faturave mujore dhe duke u bazuar ne Raportin mbi konstatimin e gjendjes të datës 01.01.2013 deri 08.06.2020 debitori ka bere pagesa te vazhdueshme te emër te konsumit te ujit. Andaj, gjykatës i ka propozuar qe prapësimin e debitorit ta refuzoj si te pabazuar. Gjykata Themelore ne Prishtine, me konkluzionet PPP.nr. 641/20 te datës 08.10.2020 dhe te datës 01.01.2021 kishte urdhëruar kreditorin qe te bej precizimin e propozimit për përmbarrim duke siguruar numrin e regjistrimit te biznesit te debitorit si dhe te dorëzoj për Gjykatën ekstraktin e verifikuar nga librat afarist ku specifikohet sakte borxhi i debitorit ndaj kreditorit për çdo muaj veç e veç. Kreditori, ne përgjigje ndaj konkluzioneve te lartcekura, me parashtresat e datës 14.10.2020 dhe te datës 08.02.2021, ka bere precizimin e propozimit për përmbarrim, duke ofruar për gjykatën numrin e biznesi te debitorit, si dhe duke precizuar periudhën kohore sipas ekstraktit te verifikuar nga librat afarist, dhe ate nga data 31.12.2006 e deri me date 29.02.2020.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, duke vendosur lidhur me prapësim e debitorit dhe përgjigjen në prapësim të kreditorit, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të LPP-së, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim, ka nxjerrë aktvendimin e atakuar KPPP.nr.388/22 të datës 23.10.2023, ku në pikën e I të dispozitivit ka aprovuar pjesërisht pranohet pjesërisht si i bazuar prapësimi i debitorit Matrix Internet-Cafe ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbarrimor P.nr. 94/2020 i datës 09.03.2020, i lejuar nga Përmbarruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi, për pjesën e detyrimit në vlerë prej 2,269.94 EUR dhe procedura në këtë pjesë të përmbarrimit përfundohet, ndërsa në pikën II. Ka vendosur që të refuzohet pjesërisht prapësimi i debitorit Matrix Internet-Cafe ashtu që mbetet në fuqi Urdhri Përmbarrimor P.nr.94/2020 i lejuar me datë 09.03.2020, nga Përmbarruesi Privat Emine Sherifi-Lubeniqi për pjesën e detyrimit në vlerë prej 91.80 EUR

Në arsyetim të aktvendimit gjykata ka vlerësuar se Urdhri Përmbarrimor P.nr.94/20, i lejuar me datë 09.03.2020, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori , me arsyetimin se me dispozitivin e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se " Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të të njëjtit nen përcaktohet se: "Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer". Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagese të secilës kërkesë veç e veç, Gjykata gjen se kërkesat e kreditorit për shërbimet nga data 31.12.2009 e deri me datën 08.03.2017 në shumën prej 2,269.94 EUR kanë arritur afatin e parashkrimit, pasi që lidhur me borxhin që rrjedh nga këto shërbime, propozimi i kreditorit për përmbarrim ishte paraqitur me datë 09.03.2020, me tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit të tyre për pagese. Andaj Gjykata gjeti se prapësimi i debitorit në raport për këtë pjesë të borxhit gjen mbështetje në kuptim të nenit 71, par.I, nën-par 1.10 të Ligjit për Procedurën Përmbarrimore i cili përcakton se: "Sipas nenit 69 të këtij ligji, prapësimi mund të bazohet vetëm nëse: 1.10. kërkesa nga dokumenti përmbarrues është e mbrojtur me ndonjë statut të kufizimeve", andaj edhe u vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij Aktvendimi, që urdhri Përmbarrimor për shumën prej 2,251.58 EUR të shfuqizohet. Ndërsa, vendimi mbi përfundimin e procedurës përmbarrimore në këtë pjesë të përmbarrimit Gjykata e morri duke u bazuar në nenin 66.4 të LPP-së i cili përcakton se "Përmbarrimi do të përfundohet edhe kur ai është bërë i pamundshëm apo kur nga shkaqe të tjera nuk mund të zbatohet, si dhe pas kalimit të afatit absolut të parashkrimit për përmbarrim".

Ndërsa gjykata e shkallës së parë vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi pjesën tjetër të Urdhrit Përmbarrimor P.nr.94/2020 të datës 09.03.2020 për borxhin në vlerë prej 91.80 EUR pasi që Gjykata gjeti se borxhi në fjali, i referohet periudhës kohore nga data 09.03.2017 e deri më datë 29.02.2020, e meqenëse propozimi për përmbarrim është paraqitur me datë 09.03.2020, Gjykata erdhi në përfundim se borxhi lidhur me shërbimet e ofruara për gjatë kësaj periudhe kohore nuk ka arritur afatin tre (3) vjeçar të parashkrimit. Po ashtu gjykata vlerësoj pretendimet e kreditorit se në rastin konkret kemi të bëjmë me ndërprerje të afatit të parashkrimit, pasi që debitori, me pagesat e datës 31.03.2015 në vlerë prej 3.48 euro dhe të datës 19.06.2015 në vlerë prej 30.00 euro ka pohar borxhin, por gjeti se këto

pagesa janë të realizuar në emër të borxhit të përgjithshëm dhe nuk specifikojnë ndonjë faturë konkrete.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e Shkalles së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore kur ka vendosur si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar meqenëse kemi parashkrim të kërkesës – kredis në kuptim të nenit 355 të LMD, siç ka konstatuar gjykata e shkallës së parë. Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 29 dhe nenin 7 të LPP-së dhe nenit 71 dhe 73 të Ligjit nr.,05/L-118” duke vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi

Në rastin konkret Gjykata e shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon në tërësi edhe Gjykata e shkallës së Dytë, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë as në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (b), (g), (j) (k) dhe (m) të LPK dhe se e as në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së Dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Përndryshe, në procedurën përmbarimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbarimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbarues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbarimin.

Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e Dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,**  
**Dhoma e Shkalles së Dytë**  
**K.Dh.Shk.II.nr.193/24 me datë 05.06.2024**

**Gjyqtari,**  
**Faton Bajrami**